



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 22.01.2013

Nr. 0204-196/4

Për: Fatime Ramadani, rruga "Agim Ramadani" pa nr. Viti

Lënda: Përgjigje në shkresë.

E nderuara Ramadani

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar një shkresë nga ju, me kërkesë për dhënë e lejes ose vlerësimin e pronës së paluajtshme pronar i të cilës jeni ju. Në përmbajtje të shkresës keni sqaruar se ju keni dashur të ndërtoni shtëpi në parcelën tuaj, por organet komunale nuk ju kanë lejuar për arsye se në vendin ku ju dëshironi të ndërtoni nuk mund të merrni leje ndërtimi, ngase ndërtimi i shtëpisë në këtë pjesë është në kundërshtim me planin urbanistik të komunës. Në shkresë gjithashtu keni potencuar se me vendim 01nr. 013/141, i datës 09.02.2012, të Kuvendit të Komunës ju keni fituar të drejtën e një parcele të dhuruar nga komuna, siç kemi kuptuar si variant të dytë për ndërtimin e shtëpisë, por pas vlerësimit të vendimit si të pa ligjshëm nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komuna e Vitisë ka anuluar këtë vendim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të hollësishëm të vendimit, ka **konstatuar se**;

- Është kompetencë ekskluzive e komunës, që konform planit urbanistik dhe planeve rregulluese të komunës të lëshoj lejen e ndërtimit të shtëpisë;
- Vlerësimi i vendimit 01nr. 013/141, i datës 09.02.2012, nga MAPL-ja, si i kundërligjshëm është bërë konform mandatat ligjor të kësaj ministrie, për shkak të mosrespektimit të procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme të komunës;

- Nëse ju keni një pronë e cila figuron në emrin tuaj, atëherë bazuar në Ligjin e ri nr. 04/L-144, Për Dhënën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale, mund të kërkontë këmbimin e pronës tuaj me pronën komunale sipas rregullave dhe procedurave ligjore të përcaktuara me këtë ligj.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është e përkushtuar të ofrojë mbështetje të nevojshme për të gjithë qytetaret e Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Besnik Osmani,
Sekretari i Përgjithshëm në MAPL;



Kopje: *Slobodan Petrovic, Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL*
Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës - Viti;
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave në MAPL;
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 22.01.2013
br. 0204-196/4

Za: Fatime Ramadani, ulica "Agim Ramadani bez br. Vitina

Predmet: Odgovor na dopis.

Poštovana Ramadani

Ministarstvo administracije lokalne samouprave je primilo jedan dopis s Vaše strane, sa zahtevom o davanju dozvole ili procent nepokretnog zemljišta u Vašem vlasništvu. Na sadržaju dopisa Vi ste objasnili da ste hteli da izgradite kuću na Vašoj parceli, međutim opštinski organi vam to nisu dozvolili sa razlogom da na to mesto gde ste Vi hteli da izgradite niste dobili dozvolu gradnje, zato što izgradnja kuće na tom delu je u suprotnosti sa urbanističkim planom opštine. Takođe na dopisu Vi ste naglasili da odlukom 01br. 013/141, i dana 09.02.2012, Skupštine opštine, Vi ste dobili pravo na jednu parcelu datu od strane opštine, kao što smo mi razumeli kao drugu varijantu o izgradnji kuće, ali nakon razmatranja odluke kao nezakonite, od strane Ministarstva administracije lokalne samouprave, opština Vitina je odbila ovu odluku.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave prema njenom mandatu definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe 02/2011o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva, nakon detaljnijeg razmatranja odluke konstatuje se, da;

- Je ekskluzivna nadležnost opštine, da u skladu sa urbanističkim planom kao i regulativnim planovima opštine da izda dozvolu o izgradnji kuće;
- Procena odluke 01br. 013/141, dana 09.02.2012, od strane MALS-a, kao nezakonito vršen je u skladu sa zakonskim mandatom ovog Ministarstva, zbog nepoštovanja procedura o davanju nepokretnog zemljišta opštine.
- Ako Vi imate neko zemljište na Vaše ime -u Vašem vlasništvu, onda prema novom zakonu br. 04/z-144, o davanju na korist nepokretnog opštinskog

zemljišta, možete tražiti razmenu Vašeg zemljišta sa opštinskim zemljištem prema uredbi i zakonskim propisima definisano ovim zakonom .

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ,posvećeno je da pruža potrebnu podršku svim građanima Republike Kosovo.

Sa poštovanjem,

Besnik Osmani,
Generalni sekretar MALS-a;



Kopije: *Slobodan Petrović, Zamenik premijera i Ministar MALS-a*
Nexhmedin Arifi, Gradonačelnik opštine Vitina ;
Direktorima odeljenja i kancelaria MALS-a;
Arhivi MALS-a

MINISTRITSE SE ADMINISTRATES SE

PUSHTETIT LOKAL

PRISHTINE

ZYRES LIGJORE

PRISHTINE.

HYRESE-ULAZHA-INCOMING REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA XHISHTIA REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data	09.01.2013		
Datum	Date		
Njësia organizative	Nr. i Lender	Shtetisa	Vlera
- III -	0204-196/7		

LENDË : KERKESË P ER DHENJEN E LEJES QSE VLERSIRIN E KOMPENZIMIT TE PRONËS SIME NE TE CILEN UNE FATIME RAMADANI JAM PRONARE E KE SAJ PALUJTESHMERIJE:

Une Fatime Ramadani nga Viti, RR Uga "NAGIM RAMADANI" p.n. Vit i ne baze te Aktgjykimit te Gjykates Komunale ne Viti C.nr.269/2006 te dates 04.07.2007 Aktgjykimi ky i plotefundishem te dates 07.07.2007.vit jam bere pronare fak tike dhe juridike te kesaj palujtshmerije.

Prove: Aktgjykimi i Gjykates Komunale ne Viti C.nr.269/2006

Gjithneshku Fatime Ramadani eshte pronare juridike e palujtshmerise ne baze te Kontrates mbi Faljen e Palujtshmerise Vr.Nr.1950/2007 Varteluar ne Gjy katen Komunale ne Viti.

+ Prove: Kontrata Nr.Vr.1950/2007 te dates 08.10.2007.vit.

Ne baze te ketije Aktgjykimi dhe ne baze te kesaj kontrate Fatime Ramadani eshte pronare juridike dhe faktike e palujt shmerise sipas Aktgjykimit per ngastren Kadastrale 1092/2 ne vendin e quajtur Stub Bregova Z.K.Germove ne sipërfaqe prej 0.10,50 ha dhe pronare juridike e palujtshmerise sipas Kon trates Vr.Nr.1950/2007 eshte pronare e ngastres nr.1093/2 ne sipërfaqe 0.01.21 ha Z.K.ne Germove. Fatime Ramadani ka bere kerkesë organit kompe tent te KK Vitise per Leje Urbanistike per ndertimin e shtepise se banimit per ngastren e vete Kadastrale dhe ate me daten 15.09.2011.vit me qense e oje jta se bashku edhe me 3 motrat tjere nuk kane shtesi banimi.

Organi kompetent i KK Vitise Fatimev Ramadani i ka kthyer pergjegje se nuk mundet ne u ndertuar ketu perkatesisht ne pergjegjjen e dates 28.12.2011 ne baze te Shkrases 11-350-15771 ke kthyer pergjegje se duke u bazuar ne plani Urban Komunal percelle nr.1092/1 nuk perfaqshet ne Zonen Ndertimore te Z.K. Germove ndaj drejtoria per Urbanizem Planifim dhe mjedise nuk jep Leje Urban stike.

Prove: Pergjegjja nr.11.te dates 27.12.2011.

Ne baze te Vendimit te dates 09.02.2012.vit te KK Vitise nr.01-013-141 Fati me KK Viti i ka dhenur ne Shfryzim siperfaqen e tokes prej 300 metra katr ror Vendimi i dates 08.02.2012. Ne Nderkohë ne Baze te Vendimit te Minis trise se Administrimit te Pushtetit lokal nr.0204-196/3 te dates 01.03. 2012.vit ky njoftim i eshte drejtuar KK Vitise ndrese Kuvendi Komunal i Vitise me ceter 19.12.2012 ne baze te Vendimit nr.01.013 1461 te dates 18 Djator e Shfundizon Vendimin e vet te cilin e ka sjellur vete keshtu ne Fatime Ramadani i pa mundeshat ndertimi i shtepise se vet ne pronen e vet perkatesisht ne palujtshmerin e saj konform vendimit ne fjale edhe nes jane bere te qjites pregaditjet per fillimin e ndertimit te shtepise se saj nga Ministria per Kinim dhe Komunitete me qense te njejtat nuk kane shtesi banimi. Nga keto erasye te thekuara me larte i Drejtchami organit kompetent ne ne kuader te ligjit autorizimeve te veta dhe kompetenceve te Vete te bjen Vendimin ose te ne kompenzoj per kete palujtshmeri apo te ne jep diku palujtshmeri per ndertimin e shtepise apo duhet te dalin ne vendin e ngjarjes per te konstatuar gjendjen faktike.

Ne 31.12.2012.a

Viti.

Kerkesen e Ushtrui:

Fatime Ramadani nga Viti.


FATIMA RAMADANI.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË : OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prashurë Mbi/Dana		19.12.2012..... vit/god	
Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-	013	1/1461	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 82.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, Rekomandimit të MAPL-së dhe nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012 aprovon këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHËSHËM FATIME RAMADANI

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë **SHFUQIZON** Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pa luajtshmërisë (tokës) në pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani me nr 01-013/141 të datës 09.02.2012.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, dhe rrjedh si pasojë e pengesave ligjore, sepse me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale duhet të zbatohen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Prokurim, neni 5 pika 2 dhe 3 të Ligjit nr 03/L-226, si dhe Udhëzimit Administrativ nr 2012/02 për zbatimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe kombinimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 3

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, **shfuqizohen** të gjitha pasojat juridike të cilat janë prodhuar me Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pa luajtshmërisë (tokës) në pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani me nr 01-013/141 të datës 09.02.2012.


Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01 Nr _____
Viti, 18 dhjetor 2012



KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Skenderbe Hebib

Skenderbe Hebib



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 02.02.2012

Nr. 0202-196

Për: Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Tënda: Vlerësim i ligjshmërisë së vendimeve lokale

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datën 09.02.2012, ka pranuar vendimin Nr.0202-196, të aprovuar në Kuvendin e Komunës së Vitisë me datë 06.02.2012, lidhur me bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë (tokë) në pronësi shoqërore, pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përkatues me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, shtojcën XI të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të vendimit në fjalë, *ka konstatuar se:*

- Vendimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë (tokë) në pronësi shoqërore, pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani, pa kompensim, është në kundërshtim me nenin 5 pika 2 dhe pika 3 të Ligjit Nr.03/L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Kombinim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili ka përcaktuar se: Kuvendi i Komunës ka të drejtë të jap në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale në alat deri në dhjetë (10) vite, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik, dhe në alat më të gjatë se dhjetë (10) vite, por jo më shumë se dyzet (40) vite, pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pëlqimit paraprak nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë.

- Bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr.03/L-226 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale personave fizik dhe juridik, duke paraqitur arsyet dhe interesin publik, ndërsa Kuvendi i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, vendos për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike komunale, duke i respektuar procedurën e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

Bazuar në atë që u tha më lartë dhe me qëllim të zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga autoritetet e Komunës, përkatësisht nga Kryetari dhe Kuvendi i Komunës së Vitisë të ndër marrir veprime konkrete që dhënie e pronës komunale në shfrytëzim të bëhet konformë dispozitave të Ligjit Nr.03/L-226 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL,
Rozafa Ukineraj, Drejtore e DVI,
Arkivi i MAPL-së.



09-02-2012

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-013/141

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 06.02.2012, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHSHËM FATIME RAMADANI

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, bënë caktimin dhe bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme (tokës) e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 898-2, lloji i pronës parcelë, zona u/r Unknown, vendi i quajtur "FSHAT", në sipërfaqe prej 300m2 Zona Kadastrale Gërmovë, nga pronari i më parshëm pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal në Viti, në bartësin e ri shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani, në Viti.

Neni 2

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën me nr 07-16/84 të datës 18.01.2012 e znj. Fatime Ramadani drejtuar Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet që të bëjë ndërrimin në regjistrin kadastral në emër të shfrytëzuesit të ri Fatime Ramadani nga Vitia.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01. Nr

Viti, 08.02.2012

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Fatime Ramadani
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOEĐVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Data e marrjes së aktit: 28.12.2011			
Nr. i urdhrimit (D.ig. 17/09)	Numri/Broji	Shitja/Prilog	Vlera/Vlerësime
11-350/1577			



Komuna e Vitisë

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
11-Nr. _____
27/12/2011

Në bazë të ligjit për Planifikim Hapsinor, ligjit nr.2003/14 neni 27.1 pika (a) dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e ligjit për Planifikim Hapsinor mbi kushtet e lokacionit, dhënien e Pëlqimit urbanistik dhe Lejes urbanistike, neni 12.3 jep këtë:

PËRGJIGJE :

Kërkesës nr.11-350/1577 të datës 15/09/2011
parashtruar nga z.Fatima Ramadani

Pas shqyrtimit të kërkesës nr.11-350/1577 të datës 15- 09-2011 e parashtruar nga z.Fatima Ramadani me vendbanim në Viti, i cili kërkesën e ka bërë për leje urbanistike, për ndërtim të ri (banim individual) në parcelën nr.1092/1 vendi i quajtur „Stub” me sipërfaqe 1050m² zona kadastrale Gërmovë.

Duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban Komunal, parcela nr.1092/1 nuk përfshihet në zonën ndërtimore të zonës kadastrale të fshatit Gërmovë, *andaj drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis nuk jep leje urbanistike për kurrëfar ndërtimi në këtë parcelë dhe në të gjitha parcelat jashtë zonës ndërtimore në tërë territorin e komunës së Vitisë.*



Drejtori


Metush Bajrami

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NË VITI, si gjykatë e shkallës së parë civile me trup gjykues të përber prej Hajriz Lubishtanit kryetar i trupit dhe gjyqtarve porot Musa Ismajli dhe Zijadin Xhymshiti antar të trupit e Sek. juridik Halit Zuka, duke vendosur në qështjen juridiko te paditëses Fatime Ramadani nga Vitia, kundër të paditurit Dobrosav Petra Sharac me vendbanim të panjohur, e përfaqesoj përfaqesusi i përkohshëm av. Misin Frangu nga Vitia, me bazë juridike vërtetimi i të drejtës së pronsijes në bazë të blerjes, në seancën gjyqësore me datën 04.07.2007, muarr këte:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkespadija e paditëses Fatime Ramadani nga Vitia dhe DETYROHET Dobrosav Petra Sharac me vendbanim të panjohur të ia njuh te drejten në pronsi paditëses ngastren kadastrale nr. 1092/2, në vendin e qujtur "Stub Bregove" me kultur arë e kl. së V. në sipërfaqe prej 0.10, 50 ha. sipas fletes poseduse nr. 39. ZK. Gërmovë.

OBLIGOHET Drejtorija komunale e gjeodezisë e katastrit dhe pronsijes në Viti, të regjistroj paditësin në emër të paditëses Fatime Ramadani nga Vitia, pas plotfuqishmeris së këti aktgjykimi.

Shpenzimet e procedures kontestimore i bartë secila pale të vetat.

A r s y e t i m

Paditësi në kërkespadijen e tij Fatime Ramadani si në padi dhe seancat gjyqësore e ka njoftuar gjykatën se babaji i saj i ndjeri Zahir Ramadani, e ka bler palujtëshmerijen diku në vitin 1975, nga i padituri, e ka permbushru qmimin e shitblerjes por gjër më tani nuk është ndrruar titullari juridik. Paditësja dekalron se në bazë të provave të administruara degjimin e deshmitarve Mem Mema nga fsh. Gërmovë, dhe Osman Ismajli nga fsh. Beguncë, si dhe provave të tjera në lëndë i ka propozuar gjykates që të aprovoj kërkespadijen e paditëses pasi që e njehta që nga viti 1975, është në shfrydzim dhe posedim të të njejtës ngaster dhe anjë her nuk është penguar nga i padituri.

Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedures.

Gjykata e ka ftuar të paditurin Dobrosav P. Sharac, pasi që i njehti nuk ka të caktuar vendbanimin apo vendqendrimin, gjyakta e ka caktur përfaqesusin e përkohshëm av. Misin Frangu nga Vitia në konform të nenit 84. al.2 të LPC. duke publikuar edhe në gazetën e përditshme. Gjykata me rastin e përcaktimit të përfaqesusit të përkohshëm që i njehti të i përfaqesoj interesat e të njejtit deri në lajmërimine tij në gjykatë ka pasur parasysh ekonomizimin e procedures dhe kohzgjatjen e lëndës në gjykatë.

Perfaqesusi i përkohshëm av. Misin Frangu në fjalën e tij të fundit nuk i ka kundërshtuar provat e administruara dhe i ka propozuar gjykates që të marrë një vendim meritor në bazë të shtjellimit të provave.,

Gjyakata ka bërë administrimin e provave duke i degjuar deshmitaret Mem Memen dhe Asman Ismajlin, ka lexur fletpagesen e dates 13.04.1975, mbi pagesen e qmimit të shitblerjes, fletën pos.nr. 39. per ZK. Gërmovë si dhe kopje planin të dates 03.07.2007, e përpiluar në vendin e ngjarjes dhe në fundë ka perfunduar se kërkespadija e paditëses është e bazur dhe është aprovuar në këte bazë.

Deklaratat e dy deshmitarve Mem Mema dhe Osman Ismajli janë identike në mes tyre nga se vërtetojnë kuartë dhe bindshëm se ne mujin prillë të vitit 1975, babaji i paditëses Zahir Ramadani, bashk me vllaun e tij Rrahman Ramadani, e kanë blerë palujtëshmerijen nga tan i padituri dhe me marveshjen e blersve pastaj është ndarë kjo palujtëshmeri, u vërtetue se babaji i paditëses ka hyrë menjihet në posedim dhe shfrydzim të të njejtës ngaster dhe asnjë her deri më tani nuk është kontestuar pronsija apo shfrydzimi i saj, fleta pos.nr. 39 në lëndë me numer dhe dat lartë cekur vërteton se palujtëshmerija evidentohet në emer të paditurit, kopja e planit të vendit të ngjarjes për ngastren 1092/2, vërteton sipërfaqen qe e posedon paditësja prej 0.10,50 ha.

Bindja e gjykatës egziston se babaji i paditëses e ka blerë palujtëshmerijen ashtu siq figuron në deklaratat e deshmitarve në lëndë dhe fletpagesen në lëndë në prill të vitit 1975, por paditësja nuk ka ndermarr veprime të ndërroj titullarin juridik nga se nuk e ka pasur interesin juridik. Gjyakata konsideron se janë përmbushur elementet e kontrates të shitblerjes është paguar qmimi i shitblerjes egziston marveshja e palëve për shitblerje dhe objekti i shitblerjes -palujtëshmerija iu është dorzuar menjihet në posedim dhe shfrydzim paditëses. Andaj gjyakata konsideron se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore në konform të nenit 73. të Ligjit mbi mardhjenjet themelore pronsoro-juridike që të bëhet konvalidimi i kontrates.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures civile u muar qe secila pale i mbanë shpenzimet e veta, pasi që paditësi nuk i ka kërkaur shpenzimet ndersa e paditura e ka humbur kontestin gjyqësore.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këti aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NË VITI


C.nr. 269/2006

Më, 04.07.2006

Sek. juridik
Halit Zuka,

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këti aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatë prej 15. ditesh, nga dita e pranimit të së njëjtës Gjykatës së qarkut në Gjilan, nepërmes të kësaj



KONTRATË E FALJES SË PASURIS SË PATUNDUR

E perpiluar me 02.10.2007 në Viti në mes të Bajram Ismajli(Ramiz) nga Debelldehu në njerën anë si faldhenes, dhe Fatima Ramadani(Zahir) nga Germova në anën tjetër si falemarrëse, kontraktuesit në tekstin e më poshtëm u morën vesh me sa vijon :

I

Kontraktuesi i parë Bajram Ismajli është pronarë juridike i ngastres kadastrale nr 1093/2 me nr.planit 6 skica8 me kultur are kl.5 në vendin e quajtur ,stub bregovo, në sipërfaqe prej 0.01.21ha, e cila evidentohet në fletën poseduese nr.408 në zonën kadastrale Germove.

II

Kontraktuesi i parë, Bajram Ismajli ngastren e lartecetur nr 1093/2 në tere sipërfaqen e saj prej 0.01.21 ha ia fale Fatima Ramadani nga Germova , njëherit duke garantuar se ngastra e lartecetur nukë është nën kurrfar garkese, hipoteke, servitut apo diq tjetër, me qka edhe falemarrësja u pajtua.

III

Kontraktuesit e larte cekur u dakorduan që vlera e kesaj kësaj kontrate të jetë në shumën e pergjithshme prej 1.210euro(nje mije e dyqinde e dhjet euro).

IV

Kontraktuesit janë marr vesh që të heqin dorë nga qfardo kontesti, por në raste se vie deri të kontesti për pasurin e patundur e cila është lende e kesaj kontrate, kompetente të jetë Gjykata komunale në Viti.

V

Pulet u dakorduan që shpenzimet rreth vertetimit të kesaj kontrate dhe rexhistrimit në librat kadastral të bien në barre të falemarrësit.

VI

Kjo kontrate është bere në ekzemplare të mjaftueshem e cila do të iu sherbej vetë kontraktuesëve si dhe organeve tjera kompetente si Gjykates Komunale dhe Drejtorise per Gjeodezi, Kadaster, Prone dhe Urbanizem në Viti.

KONTRAKTUESIT


Faldhenesi :

Bajram Ismajli (Ramiz)
Nga Debulldehu

Nr.1002878875-Unmik

Falemarrësja :

Fatima Ramadani (Zahir)
nga Germova


nr.1173512101-Unmik

VR.nr. 1950/2007

VERTETOHET SE: Kontraktuesit: **Bajram Ismajli** nga **Debelldehu** falëdhënës, identiteti i së cilës vërtetohet, në bazë të Lnj.1002878875 lëshuar nga Unmik Prishtinë. dhe **Fatima Ramadani** si falëmarrëse, identiteti i të cilit vërtetohet në bazë të LNJ.1173312101 të lëshuar nga Unmik Prishtinë , të cilët personalisht dhe me dorë të vet e kanë nënshkruar këtë kontratë mbi faljen e palujtshmëris dhe të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat rrjedhin nga përmbajtja e saj i pranojnë për të vetat.

Taksat gjyqësore në shumë prej 10,00 €, janë paguar në bankë.

GJYKATA KOMUNALE NË VITI, me.08.10.2007



Punëtori i autorizuar

Qibrije Alidema